



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Nr. _____ Prot

Tiranë më __/__/2019

Lënda : Amendament për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9975,datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare “ ,të ndryshuar “”.

Drejtuar : z.Gramoz RUÇI

KKRYETARI I KUVENDIT TE SHQIPERISE

Tiranë

z.Kryetar .

Mbështetur në nenin 75,pika 3 dhe pika 4 të Rregullores së Kuvendit ,paraqes për shqyrtim dhe miratim në Kuvend amendamentin mbi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9975,datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare “ ,të ndryshuar “”.

Bashkëlidhur gjeni tekstin e amendamentit dhe relacionin shoqërues.

Duke ju kërkuar mirkuptimin,

Deputeti propozues

Artur ROSHI

ARTUR ROSHI

AMENDAMENT

“Neni 5, pika a, i projektligjit të ndryshohet si më poshtë:

“ Neni 5

- a) Në shkronjën “ç”, të pikës 1, pas fjalëve “...invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, personat me aftësi të kufizuara “ shtohen “... dhe të gjithë ata që gëzojnë statusin e ish të përndjekurve politikë, dhe kanë mbushur moshën e pensionit..” ”

RELACION

Me anën e këtij neni, pra të Nenit 5, kërkohen ndryshime të Nenit 9, të ligjit Nr.9975, datë 28.7.2008, “Përfshirja nga pagimet e taksave kombëtare “ të ndryshuar “, të cilat synojnë shtimin e kategorisë së ish të përndjekurve politikë që sakrifikuan rininë e jetës së tyre për lirinë dhe demokracinë.

Togfjalëshi “Veteranë Lufte”, në vlerën kuptimore të saj ka një kontribut të caktuar për lirinë e një vendi të caktuar.

Jemi në analogji të plotë në thelbin e këtij kuptimi kur e krahasojmë me kontributin e ish të përndjekurve politikë për lirinë dhe demokracinë e vendit tonë.

Ata humbën rininë e tyre në funksion të Lirisë, që është sharniera kryesore hapsinore në një sistem demokratik.

Kur themi që në këtë ligj përfshijmë kategoritë e kontributeve të lirisë në shërbim të sakrificave të tyre nuk mund të bëjme diferencime emocionale, midis grupeve që përmenda më lart, “Veteranëve” dhe “Ish të Përndjekurve”, porë kjo vetëm në logjikën e këtij ligji.

Për këtë arsye propozoj që kategoria me statusin e “Ish të Përndjekurve”, që kanë mbushur moshën e pensionit, të përfitojnë nga kjo ngarkesë fiskale.

Deputeti



ARTHUR ROSHI